



Vërtetimi Online

Manual për shkarkimin e vërtetimit online nga ana e studentit në SEMS

Data: 24.01.2023

Versioni: 1.0

HYRJE

Pasi të jemi kyçur në SEMS, klikojmë në menynë Vërtetimi Online.




Figura 1: Pamja kryesore

Pasi të kemi klikuar në menynë **Vërtetimi online**, atëherë na paraqitet përmbajtja e kësaj menyje sikurse në figurën si më poshtë.




Figura 2: Menyja Vertetimi online

Për të filluar me shkarkimin e vërtetimit online, duhet të klikojmë mbi butonin **Shkarko**, i cili na e hap një dritare, në të cilën duhet ta zgjedhim semestrin për shkarkimin e vërtetimit online.

Vërejtje: Për t'iu lejuar shkarkimi i vërtetimit online, studenti duhet ta ketë të regjistruar së paku njërin nga semestrat për vitin e fundit akademik.




Figura 3: Shkarkimi i vertetimit online

Pasi ta zgjedhim semestrin, klikojmë në butonin **Ruaj**, i cili gjeneron me sukses vërtetimin, të cilin mund ta printojmë duke klikuar në butonin Printo, në gjuhën **shqipe** apo **angleze**.




Figura 4: Printimi

Pasi të klikoni në butonin Printo, atëherë me sukses do të shkarkohet vërtetimi juaj online.

Vërejtje: Ju mund ta shkarkoni vërtetimin online vetëm 2 herë brenda vitit akademik, pra për semestrin dimëror dhe semestrin veror. Kjo nuk do të thotë që ju nuk do të mund t'i printoni shkarkimet e juaja më shumë se dy herë. Ju mund t'i printoni vërtetimet e regjistruara për atë vit akademik sa herë të dëshironi.

SIGURIA E DOKUMENTIT

Sa i përket sigurisë së dokumentit të lëshuar nga SEMS-i, dokumenti është i nënshkruar me nënshkrim digjital dhe çfarëdo ndërhyrje në dokument shkakton humbjen e këtij nënshkrimi dhe dokumenti bëhet i pavlefshëm.

Nënshkrimin e dokumentit mund ta verifikoni duke përdorur Adobe Acrobat Reader, i cili tregon se dokumenti është i nënshkruar nga UP-ja dhe se nuk ka pasur modifikime në dokument.

Po ashtu dokumenti mund të vërtetohet në dy mënyra që është lëshuar nga SEMS-i dhe ta shihni edhe një kopje të atij dokumenti se a janë të dhënat e njëjta.

Mënyra e parë për vërtetimin e dokumentit është duke skanuar QR code, i cili gjendet në vërtetim, i cili do t'ju shkarkojë automatikisht një kopje të dokumentit.

Mënyra e dytë për vërtetimin e dokumentit është duke klikuar në linkun: <https://sems.uni-pr.edu/certificate> dhe duke shënuar numrin serik të dokumentit dhe ID-në e studentit, sistemi ju tregon nëse ky dokument është lëshuar nga SEMS-i apo jo, si dhe mund ta shkarkoni një kopje të dokumentit.